

## Llojet e Çështjeve:



ÇESHTJE FAMILJARE



KUJDESTARIA



REGJISTRIM CIVIL



STREHIMI



SHËNDETI



PËRKRAHJE SOCIALE



TË DREJTAT E NJERIUT


### Parimet themelore të Ndhmës Juridike

#### Ndihma juridike bazohet në parimet e:

- Barazisë së të drejtave për individët që përfitojnë ndihmë juridike;
- Profesionalizmit të atyre që japin ndihmën juridike;
- Cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike; dhe respektimi i konfidencialitetit;



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



[www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)

Shtrirja e shërbimeve ligjore falas në bashkëpunim me strukturat lokale

# KENI NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE?

04 2258442 - 0692093731  
[tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al) - [www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)  
[www.portal.tlas.org.al](http://www.portal.tlas.org.al)

Pallatet Agimi, Shkalla 18 / 322  
P.O BOX 69, Tiranë - Shqipëri

Kjo fletë informuese u prodhua nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë në kuadër të projektit, Shtrirja e shërbimeve Ligjore Falas në nivel lokal si pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

## Çfarë kuptojmë me Ndhmë Juridike

Me Ndhmë Juridike kuptojmë ofrimin e shërbimit ligjor falas për individët në pamundësi financiare për të zgjidhur dhe realizuar të drejtat e tyre.

## Cilat janë format e Ndhmës Juridike që do të ofrohen nga ky projekt?

### 1. Ndhma Juridike parësore përfshin:

- Informacionin për sistemin ligjor dhe aktet normative në fuqi;
- Për të drejtat e detyrimet e subjekteve të ligjit;
- Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit në proceset gjyqësore, administrative etj.
- Për hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.
- Shërbim klinik dhe Law Line për klientët që mbasi këshillohen dhe përgatiten me dokumentat përkatëse ligjore, mund të vet-përfaqësohen në administratën publike apo gjykatë.
- Shërbim Ligjor Falas përmes internetit
- Çdo qytetar mund të marrë informacion juridik dhe modele te gatshme (padish etj), për çeshtje te ndryshme, nëpërmjet portalit të TLAS.

### 2. Ndhma Juridike dytësore përfshin:

- Këshillimin, përfaqësimin në proceset gjyqësore, civile dhe administrative;
- Çeshtjet që do të trajtohen me prioritet për përfaqësimin në gjykatë do t'i perkasin kryesisht familjeve ekstremisht të varfëra:
- Çeshtjet familjare.
- Çeshtjet e regjistrimit civil.
- Çeshtjet që lidhen me të drejtat ekonomike dhe sociale.

### 3. Ndhma juridike nëpërmjet edukimit ligjor të publikut:

- Përmes publikimeve; informacion ligjor dhe shpërndarje e fletëpalosjeve.
- Fushatave televizive, në mediane shkruar dhe ate sociale; prezantim i projektit në televizionet lokale dhe median sociale te TLAS në facebook.
- Aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese në komunitet nga grupi i Studentëve të Fakultetit Juridik;
- Aktivitetet Street Law.

**Ky projekt ka për fokus dhënien e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për fëmijët më në nevojë dhe familjet e tyre**

## Cilët persona do të përfitojnë Ndhmë Juridike?

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët kanë nevojë për Ndhmë Juridike në çeshtjet civile ose administrative dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar. Në këtë rast, personi duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to, si:

- Të miturit dhe jetimët.
- Gratë e dhunuara dhe personat me aftësi të kufizuar.
- Minoritetet etnike, seksuale.
- Të moshuarit, etj.

## Ku do të kontaktojmë Avokatin e Ndhmës Juridike?



**SHËRBIMI LIGJOR FALAS  
TIRANË**

04 2258442 - 0692093731  
tlas@tlas.org.al - www.tlas.org.al  
www.portal.tlas.org.al

Pallatet Agimi, Shkalla 18 / 322  
P.O BOX 69, Tiranë - Shqipëri